



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.128 dt.30.10.2001

**PER
KRIJIMIN E KESHILLIT TEKNIK TE DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE
PUNEVE PUBLIKE**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Neni 32, gërma k dhe ç, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë krijimin e Këshillit Teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike me këtë përbërje:

1.Zv/Kryetari i Bashkisë	KRYETAR
2.Drejtori i Përgjithshëm i Punëve Publike	N/KRYETAR
3.Drejtori i Dr. së Projekteve të Infras.	ANETAR
4.Drejtori i Dr. së Infrastrukturës së Rëndë	ANETAR
5.Drejtori i Dr. së Infrastrukturës së Lehtë	ANETAR
6.Shef i Sek. të Proj të Infrastrukturës së Lehtë	ANETAR
7.Shefi i Sek. të Proj të Infrastrukturës së Rëndë	ANETAR
8.Drejtori i Ujësjetës-Kanalizimeve sh.a	ANETAR
9.Zv/Drejtor i Ujësjetës-Kanalizimeve sh.a	ANETAR
10.Drejtori i Nd. Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit	ANETAR
11.Drejtori i Drejtorisë së Përgj. Nr.1 të Qytetit	ANETAR

12.Specialist i Drejtorisë së Projekteve të Infrastrukturës SEKRETAR

2. Detyrat e Këshillit Teknik të Drejtorisë së Punëve Publike janë si më poshtë:

Miratimi i prioriteteve në fushën e veprimtarisë së D.P.P.P dhe koordinimi me institucione të tjera si K.E.SH, Telekom, lidhur me këto prioritete

Miratimi i detyrave të projektimit të hartuara nga kjo Bashki

Miratimi i projekteve të hartuara nga bashkia jonë me specialistët e saj ose me specialistë të jashtëm

Miratimi i strategjive në drejtim të ndërhyrjes në infrastrukturën e rëndë dhe të lehtë

Miratimi dhe paraqitja në organe më të larta kompetente i normativave të ndryshme duke i afruar ato me standartet europiane

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike për zbatimin e këtij vendimi
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

